REPUBLIKA E KOSOVËS★REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit ★ Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Administratës
Direktorijat za Administraciju
Yönetim Müdürlüğü
3 HYRËSE-ULAZ-GIRIŞ
R-332 Nr 140889 Dt. 09.11.26

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
Direktorijat za Turizam i Ekonomski Razvoj / Turizm ve Ekonomik Kalkinma Müdürlüğ

Datë: 09/11/2026

Thirrje për shfrytëzimin e Shtëpizave në kuadër të festës "Dimri Kulturor"

Qëllimi

Komuna e Prizrenit përmes organizimit të aktivitetit "Dimri Kulturor", hap thirrjen për përzgjedhjen e bizneseve që do të shfrytëzojnë shtëpizat e drurit në "sheshin e Lidhjes", gjatë festave të fundvitit.
Bizneset e përzgjedhura do të ofrojnë produkte gastronomike dhe shërbime me tematikë dimëror dhe turistik.

Vendi dhe Orari i Punës:

Hapja zyrtare e aktivitetit të shtëpizave dhe festimeve të Fundvitit do të bëhet sipas planifikimeve të drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për të cilët do të njoftohet paraprakisht përfituesit.

Bizneset do të operojnë çdo ditë pune nga ora **12:00h – 24:00h**.

Hapja e operimit të biznesit pas orës **12:00h sjell humbjen e të drejtës së shfrytëzimit** të shtëpizës.

Kriteret e aplikimit dhe operimit

Përzgjedhja e biznesete do të bëhet nga Komisioni i Komunës së Prizrenit.
Numri i shtëpizave është i kufizuar.
Kriteret përcaktuese janë:

- Bizneset duhet të jenë të regjistruar në ATK, me aktivitetet që operojnë në Komunën e Prizrenit;
- Të dorëzojnë deklaratë nga ATK që nuk kanë obligime të papaguara;
- Të paraqesin menynë me çmime;
- Lejohen vetëm artikujt e miratuar në aplikim;
- Bizneset të përzgjedhura do t'u lejohet një numër i caktuar i shankereve dhe burëve para shtëpizave;
- Të vendosin shporta mbeturinash dhe të mirëmbajnë pastërtinë.

SHËNIM: Lokacionet e shtëpizave caktohen nga Komuna e Prizrenit, sipas planifikimeve gjithëpërfshierese.

Përparësi në përzgjedhje

Përparësi do të kenë:

- Bizneset që promovojnë përdorimin e produkteve lokale/ vendore.
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative dhe produkte me motive të stinës së dimrit.

Kriteret objektive për përzgjedhje:

- Produkte vendore / tradicionale;
- Brendim i rregullt dhe imazh profesional;
- Produkte inovative me motive festive;
- Përvojë në aktivitete turistike ose panaire;
- Koncept festiv i qartë dhe i realizueshëm.
- Qarkullim financiar stabil.

Kodi i Mirësjelljes dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë. Ndalohet rreptësishtë:

- Kryerja e veprave të paligjshme ose akteve të dhunshme brenda zonës.
- Abuzimi verbal dhe fizik ndaj personave.
- Shitja e produkteve që nuk janë të parashikuar në aplikim.
- Mosmbajtja e pastërtisë brenda dhe rreth shtëpizës.

- **Dy ankesa të përsëritura për mospastrimin e hapësirës sjellin shkëputjen e menjëhershme të marrëveshjes**

Muzika dhe Performanca

- Muzika dhe aktivitetet artistike organizohen nga Komuna duke respektuar pozicionet e kontratës.
- Muzika apo performancat individuale të bizneseve janë të ndaluar rreptësisht.

Mënyra e aplikimit

- Plotësoni aplikacionin e bashkangjitur
- Dokumentet e domosdoshme:

  Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit me detaje (përfshirë veprimtarinë kryesore të biznesit)
  Deklarata e ATK
  Menyja me çmime
  Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit
- Aplikuesit që ofrojnë ushqim dhe/ose pije duhet të dorëzojnë menynë përkatëse me çmime.
- Lejohet vetëm një aplikim për një person juridik; Aplikuesi duhet të jetë pronar biznesi.

Afati i aplikimit:

09/11/2026 – 13/11/2026 nga 08:30 – 16:00, në objektin e Komunës së Prizrenit, tek sporteli i kërkesave.

Çdo aplikim duhet të protokollohet me emërtimin:

"Kërkesë për shfrytëzimin e Shtëpizave për Festat e Fundvitit"

Më pas do njoftohen te gjithë përfituesit për procedurat të mëtejme.

Vërejtje:

Biznesi, i cili pas shqyrtimit të aplikacioneve nga ana e Komisionit fiton të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës për të operuar, nuk ka të drejtë të nënkontraktojë ose të bëjë marrëveshje me ndonjë biznes tjetër për operim, në të kundërtën do të ndërpritet kontrata.

Drejtori i DTZHE-së
Adem Morina